

# SHQYRTIM DHE ANALIZË E MANGËSIVE PËR LIGJIN E ZONAVE TË MBROJTURA

## Raporti Shpjegues

**Përgatitur nga Ekspertët Ligjorë:**

Elvana Tivari  
Irene Dule  
Vladimir Meçi  
Dorian Matlija

**Mars 2024**

## Përmbajtje

I.	HYRJE	2
II.	STANDARDET DHE UDHËZIMET E PËRDORURA SI KRITERE KRAHASIMI	3
III.	PËRMBLEDHJE E LIGJIT 81/2017 “PËR ZONAT E MBROJTURA”	4
1.	FUSHA E ZBATIMIT DHE PARIMET	4
2.	NIVELET E MBROJTJES DHE KATEGORITË E ZM-VE	4
3.	INSTITUCIONET DHE AKTORËT PËRKATËS	5
4.	PROCESI I PLANIFIKIMIT, KRIJIMIT DHE RISHIKIMIT TË ZONAVE TË MBROJTURA	7
5.	ZONIMI, PËRDORIMET DHE VEPRIMTARITË	8
5.1	ZONIMI	8
5.2	VEPRIMTARITË E LEJUARA DHE TË NDALUARA (TË ZBATUESHME MBI TË GJITHA ZM-TË)	9
6.	QEVERISJA DHE FORMA E MENAXHIMIT/ADMINISTRIMIT	13
7.	MBIKËQYRJA DHE KOORDINIMI:	15
8.	TË ARDHURAT E ZM-VE DHE FONDET BUXHETORE:	16
9.	MONITORIMI DHE INSPEKTIMI	19
10.	BURIMET NJERËZORE	19
IV.	GJETJET KRYESORE TË SHQYRTIMIT DHE ANALIZA E MANGËSIVE	20
1.	LIGJI DUHET AMENDUAR PËR SAKTËSIMIN E ZONIMIT DHE AKTIVITETEVE	20
2.	LIGJI DUHET TË MISHËROJË SHPREHIMISHT MODELET E QEVERISJES TË NJOHURA NGA IUCN	21
3.	LIGJI I ZM-VE DUHET TË ZGJEROJË OPSIONET LIDHUR ME MEKANIZMAT E FINANCIMIT	26
4.	LIGJI I ZM DUHET PËRFARUAR ME DIREKTIVAT E BE-SË DHE SAKTËSUAR NË ÇËSHTJE TEKNIKE	27
V.	SHPJEGIM ANALITIK I NDRYSHIMEVE TË PROPOZUARA	28

## I. HYRJE

Ligji 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” (Ligji i ZM-ve), i cili shfuqizon dhe zëvendëson ligjin nr. 8906, datë 60. 06. 2002 “Për zonat e mbrojtura” i ndryshuar, u botua me Fletoren Zyrtare nr. 116, datë 23. 05. 2017 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë nga data e botimit në Fletoren Zyrtare. Ligji i ZM-ve është pjesërisht i harmonizuar me Direktivën 92/43/KEE, datë 21 maj 1992 “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër”.

Ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” përfshin shpalljen, mbrojtjen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe burimeve të tyre natyrore dhe biologjike, bazuar në parimin e qëndrueshmërisë. Zonat e mbrojtura krijohen për mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit, peizazheve dhe trashëgimisë natyrore e kulturore dhe menaxhohen në bazë të instrumenteve ligjore, sipas kategorive të menaxhimit.

Zbatimi i kuadrit ligjor ekzistues të kohëve të fundit për Zonat e Mbrojtura (ZM-të) sa i takon planifikimit, deklarimit (shpalljes), menaxhimit dhe monitorimit të një ZM-së, ka nxjerrë në pah disa sfida që duhen kapërcyer duke rishikuar Ligjin për ZM-të.

Kuadri ligjor në fuqi për Zonat e Mbrojtura (ZM) është miratuar kohët e fundit, kështu që zbatimi i tij ende nuk është testuar plotësisht për sa i përket planifikimit, deklarimit (shpalljes), menaxhimit dhe monitorimit të një ZM-je, e aq më pak për sa i përket një rasti të ngjashëm me PKLEV-në.

Qëllimi i këtij Shqyrtimi dhe Analizës së Mangësive (ShAM) është që të vlerësojë legjislacionin ekzistues shqiptar dhe të identifikojë mangësitë kryesore dhe dispozitat që mund të kenë nevojë të shtohen dhe/ose të rishikohen përmes ndryshimeve ligjore, pra, të kontrollojë ligjin ekzistues për ZM-të për mangësi dhe/ose mospërputhje.

Gjetjet e evidentuara, nëse trajtohen përmes ndryshimeve ligjore do të çojnë në një ligj më të mirë për ZM-të, të përafuar më tej me standardet përkatëse të Bashkimit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës dhe Burimeve Natyrore (IUCN) dhe me *Acquis Communautaire* të BE-së.

## II. STANDARDET DHE UDHËZIMET E PËRDORURA SI KRITERE KRAHASIMI

Vlerësimi, analizat dhe hartimi i ndryshimeve të propozuara ka përdorur si kritere standarde udhëzimet e mëposhtme të IUCN-së dhe legjislacionin e BE:

### Udhëzimet e IUCN-së :

- Dudley, N. (ed.) (2008). Guidelines for Applying Protected Area Management Categories. (Udhëzime për përdorimin e kategorive të menaxhimit të zonave të mbrojtura) Gland, Zvicër: IUCN. Dudley, N., Shadie, P. and Stolton, S. (2013). Best Practice Protected Area Guidelines Series No. 21. (Seria nr. 21 e udhëzimeve të praktikave më të mira për zonat e mbrojtura) Gland, Zvicër: IUCN.
- Lausche, Barbara. (2011). Guidelines for Protected Areas Legislation. (Udhëzime për Legjislacionin për Zonat e Mbrojtura). IUCN, Gland, Zvicër.
- Borrini-Feyerabend, G., N. Dudley, T. Jaeger, B. Lassen, N. Pathak Broome, A. Phillips dhe T. Sandëith (2013). Governance of Protected Areas: From understanding to action. Best Practice Protected Area Guidelines Series No. 20 (Qeverisja e Zonave të Mbrojtura: Nga të kuptuarit te veprimi. Seria nr. 20 e udhëzimeve të praktikave më të mira për zonat e mbrojtura), Gland, Zvicër: IUCN.
- Thomas, Lee and Middleton, Julie, (2003). Guidelines for Management Planning of Protected Areas. IUCN Gland, Sëitzaerland and Cambridge, UK

### Legjislacioni i BE-së:

- Direktiva e Këshillit 79/409/EEC “Për ruajtjen e shpendëve të egër” (Direktiva për Zogjtë), 25 prill 1979 (ndryshuar së fundi nga Direktiva 2009/147/EC)
- Direktiva e Këshillit 92/43/EEC “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe faunës dhe florës së egër” (Direktiva e Habitaveve), 21 maj 1992.

Ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse shqiptare të shqyrtuara për qëllimin e këtij vlerësimi jepen në Shtojcën 2 bashkëlidhur – Kuadri Ligjor Përkatës, i ndarë në: (i) Ligje; (ii) akte nënligjore të nivelit të parë që përfshijnë Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM); (iii) akte nënligjore të nivelit të dytë që përfshijnë Urdhra dhe Udhëzime të Ministrit përgjegjës për ZM-të; dhe (iv) akte nënligjore të ardhshme të pritshme (të cilat nuk janë miratuara ende), të parashikuara nga Ligji për ZM-të, si mjete zbatuese të dispozitave të veçanta të Ligjit për ZM-të.

### **III. PËRMBLEDHJE E LIGJIT 81/2017 “PËR ZONAT E MBROJTURA”**

Ligji 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” (Ligji për ZM-të), i cili shfuqizon dhe zëvendëson Ligjin nr. 8906, datë 06. 06. 2002 “Për Zonat e Mbrojtura”, i ndryshuar, është botuar me Fletoren Zyrtare nr. 116, datë 23. 05. 2017 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas datës së botimit në Fletoren Zyrtare.

Ligji për ZM-të është pjesërisht i harmonizuar me Direktivën 92/43/EEC, datë 21 maj 1992 “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe faunës dhe florës së egër”.

#### ***1. Fusha e zbatimit dhe parimet***

**Nenet 1, 2 dhe 4 të Ligjit për ZM-të**, parashikojnë që fusha e zbatimit të ligjit përfshin shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe të burimeve të tyre natyrore e biologjike, bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, për të garantuar përmbushjen e funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale dhe kulturore, si dhe përcaktojnë përgjegjësitë e institucioneve publike dhe personave fizikë/juridikë privatë për ruajtjen dhe administrimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura.

Parimet që rregullojnë menaxhimin e zonave të mbrojtura janë si më poshtë:

- a. zhvillimi i qëndrueshëm;
- b. integrimi i politikave të mbrojtjes së mjedisit në ato të zhvillimit ekonomik;
- c. zbatimi i parimit “ndotësi paguan”;
- d. parandalimi dhe marrja e masave paraprake.

#### ***2. Nivelet e mbrojtjes dhe kategoritë e ZM-ve***

**Nenet 3, 48, 49, 50 të Ligjit për ZM-të** përcaktojnë shprehimisht tri shkallë mbrojtjeje, duke filluar nga shkalla (I) strikte e mbrojtjes, e cila kërkon mbrojtjen tërësore të biodiversitetit dhe sigurimin e zonave natyrore të pashqetësuar, deri në shkallën (III) të mbrojtjes, e cila kërkon ruajtjen e natyrës dhe të biodiversitetit në harmoni me zhvillimin e veprimtarive social-ekonomike e turistike, të infrastrukturës për banorët e zonës dhe komunitetin e biznesit. Shkalla (II) e mbrojtjes është shkalla e mbrojtjes që ka si funksion ruajtjen parësore të biodiversitetit dhe sigurimin e një zone natyrore pak të shqetësuar nga veprimtaritë tradicionale dhe ekoturistike.

Nenet 6 dhe 14 të Ligjit për ZM-të, parashikojnë se zonat e mbrojtura në Shqipëri kanë rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare.

Neni 9 i Ligjit specifikon objektivat e përgjithshme të cilat vlejnë për të gjitha kategoritë e zonave të mbrojtura: Qëllimi i përgjithshëm i të gjitha zonave të mbrojtura është:

- të përjashtojë zonat e mbrojtura nga shfrytëzimi ose zënia me aktivitete intensive nga ana e njeriut.
- të ndalojë ndërtimin e zonave urbane, si autostradave, hekurudhave, linjave të tensionit të lartë, veprave të mëdha hidrike dhe sistemeve të naftës e të gazit me shtrirje të gjatë.
- të ndalojë ndryshimin e gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe ligatinave.

I njëjti nen ndalon gjithashtu (në zonat e mbrojtura) shfrytëzimin e tokës nga teknologji intensive, me mjete ose mënyra që shkaktojnë ndryshime thelbësore në biodiversitetin, strukturën dhe funksionet e ekosistemit ose dëmtojnë në mënyrë të pakthyeshme sipërfaqen e tokës.

Kategoritë kombëtare të zonave të mbrojtura të kategorizuara në përputhje me standardet e IUCN-së janë: rezerva strikte natyrore/rezervat shkencore – Kategoria I (**neni 15**); parku kombëtar (**neni 16**) – Kategoria II; monumentet natyrore – Kategoria III (**neni 17**); rezervat natyrore të menaxhuara/parku natyror – Kategoria IV (**neni 19**); peizazhi i mbrojtur – Kategoria V (**neni 20**); zona e mbrojtur e burimeve të menaxhuara/zona e mbrojtur me përdorime të shumëfishta – Kategoria VI (**neni 21**); kurotrat e gjelbra (rreth qyteteve) – Kategoria V dhe parqet natyrore bashkiake – Kategoria IV (**neni 23 dhe 24**).

Për më tepër, **nenet 22 dhe 25 të Ligjit për ZM-të** përmbajnë dispozita për zonat e mbrojtura detare dhe ato ndërkufitare.

**Nenet 26 – 32** të Ligjit për ZM-të përmbajnë dispozita mbi zonat e mbrojtura me rëndësi ndërkombëtare (zonat Ramsar, SCI dhe SPA (zonat e ardhshme Natura 2000), zonat e smeraldit, rezervatet e biosferës dhe zonat e trashëgimisë natyrore.

### ***3. Institucionet dhe aktorët përkatës***

**Neni 3 i Ligjit për ZM-të** jep përkufizimet e koncepteve kryesore të përdorura në Ligjin për ZM-të, duke përcaktuar në mënyrë specifike autoritetet përgjegjëse dhe të përfshira në veprimtarinë e mbrojtjes dhe menaxhimit të ZM-ve: (i) Administratën e ZM-së (AZM) – neni

3 (1); (ii) AdZM-të – neni 3 (2); (iii) AKZM-në, neni 3 (3); dhe (iv) Ministrin dhe Ministrinë përgjegjëse për ZM-të, neni 3 (12) dhe (13).

**Nenet 37 – 41 të Ligjit për ZM-të** parashikojnë që përgjegjësitë për krijimin e zonave të mbrojtura dhe menaxhimin e tyre ndahen ndërmjet Ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM), dhe Bashkive dhe Komiteteve të Menaxhimit.

Ministria është institucioni qendror politikëbërës për mbrojtjen dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura në Republikën e Shqipërisë. Ajo është përgjegjëse për:

- propozimin e shpalljes së krijimit, ndryshimit dhe revokimit të zonave të mbrojtura,
- hartimin dhe miratimin e planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura,
- zonimin,
- zgjerimi dhe/ose zvogëlimi i sipërfaqes së zonave të mbrojtura dhe
- rishikimin e statusit të zonave të mbrojtura

Ministria përkatëse, në bashkëpunim me ministritë e tjera, bashkitë, publikun e interesuar, shoqërinë civile dhe pronarët privatë, toka e të cilëve ndodhet brenda territorit të zonës së mbrojtur, miraton planin e menaxhimit për secilën nga zonat e mbrojtura.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), në varësi të ministrit, është institucioni qendror shtetëror përgjegjës për zonat e mbrojtura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për menaxhimin dhe kontrollin e tyre; në nivel lokal organizohet në nivel rajonal në trajtën e autoriteteve rajonale të zonave të mbrojtura. Struktura dhe organizimi i AKZM-së dhe institucioneve në varësi të saj miratohet me udhëzim të Kryeministrit.

Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM) janë institucione në varësi të AKZM-së, me seli në çdo qark dhe që përbëjnë rrjetin institucional të specializuar lokal përgjegjës për mbrojtjen dhe zhvillimin e zonave të mbrojtura në territorin e qarkut.

Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre në lidhje me zonat e mbrojtura, bashkitë bashkëpunojnë me Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura dhe administratat e zonave përkatëse dhe, në përputhje me ligjin organik dhe kapacitetet e tyre, krijojnë njësitë e tyre për mbrojtjen e mjedisit.

Për të ndjekur zbatimin e planeve të menaxhimit në zonat e mbrojtura ngrihen Komitetet e Menaxhimit, me përbërje nga bashkia, brenda territorit administrativ të së cilës ndodhet zona e mbrojtur, AKZM-ja, nga institucionet vendore që kanë lidhje direkte me to, si të

bujqësisë, të turizmit, të infrastrukturës, shoqërisë civile, përfaqësues nga pronarët e pyjeve e kullotave që gjenden në zonat e mbrojtura dhe drejtohen nga prefekti.

Ministria, AKZM-ja dhe pushteti vendor inkurajojnë nisma, projekte dhe programe, të cilat kërkojnë përmirësimin e indekseve ekologjike dhe natyrore të zonave të mbrojtura. Toka brenda zonave të mbrojtura mund të jetë pronë private ose publike.

Për sa i përket pronës private dhe administrimit të pronave private që përfshihen në këtë ligj, toka private dhe objektet private administrohen dhe përdoren nga pronari/pronarët ose zotëruesit e ligjshëm, vetëm në përputhje me kërkesat e planit të menaxhimit të zonës së mbrojtur në fjalë.

Pronarët privatë, pronat e të cilëve janë përfshirë në zonën e mbrojtur mjedisore, si dhe përdoruesit e këtyre pronave marrin pjesë në planifikimin, ruajtjen dhe përdorimin e burimeve natyrore të zonës. Ata bashkëpunojnë me administratën e zonës dhe zbatojnë rregullat e caktuara, planet e menaxhimit dhe programet e hartuara për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

#### ***4. Procesi i planifikimit, krijimit dhe rishikimit të zonave të mbrojtura***

Zonat e mbrojtura në territorin e Republikës së Shqipërisë janë pasuri kombëtare; pronësia mbi pasuritë e paluajtshme në zonat e mbrojtura mjedisore është shtetërore ose private **(neni 7)**.

Planifikimi, bashkërendimi dhe drejtimi për ngritjen e sistemit kombëtar të zonave të mbrojtura mjedisore specifikohet në Planin Specifik të tërësisë së zonave. Ministria, në bashkëpunim me AKZM-në, harton Planin Specifik, i cili miratohet me Urdhër të Ministrit **(neni 5)**.

Identifikimi dhe administrimi i zonave të mbrojtura bëhen në përputhje me Planin Specifik të zonave të mbrojtura dhe planin e administrimit të rrjetit ekologjik të vendit, si dhe dokumente të tjera strategjike të fushës së mbrojtjes së natyrës. **(neni 10)**

Zonat e mbrojtura mjedisore shpallen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura. Në vendimin për shpalljen e zonës së mbrojtur mjedisore përcaktohen emërtimi, kategoria, sipërfaqja, institucioni menaxhues, objektivat e ruajtjes së zonës dhe shkalla e mbrojtjes së nënzonave të zonës së mbrojtur. Deklarimi i zonës së mbrojtur bëhet në përputhje me Planin Kombëtar të Zonave të Mbrojtura **(nenet 5 dhe 10)**.



Për shpalljen e zonave të mbrojtura duhet të japin mendim autoritetet dhe grupet e interesuarit të renditura më poshtë:

- bashkia në territorin administrativ të së cilës ndodhet zona,
- shoqëria civile,
- komuniteti i zonës dhe
- pronarët pronat e të cilëve do të përfshihen në zonën e mbrojtur

## 5. Zonimi, përdorimet dhe veprimtaritë

### 5.1 Zonimi

Zonimi synon të zbatojë shkallën e mbrojtjes dhe të pasqyrojë tiparet e nënzonës, duke marrë parasysh natyrën e zonës, llojet e veprimtarive njerëzore që zhvillohen dhe ndikimin e tyre në mjedis. Zonimi i brendshëm duhet të jetë pjesë e VKM-së që shpall një zonë të mbrojtur, duke përfshirë minimalisht emërtimin, sipërfaqen dhe nivelin e mbrojtjes së çdo nënzona të caktuar. **(neni 10:3)**

Zonimi i brendshëm i zonave të mbrojtura miratohet edhe nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), me propozimin e ministrit, përpara hyrjes në fuqi të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave që e shpall të mbrojtur zonën mjedisore konkrete, që do t'i miratohet zonimi i brendshëm. **(neni 13:6).**

Ligji për ZM-të përmban dy nene që trajtojnë zonimin në zonat e mbrojtura **(nenet 13 dhe 47)**, por ato i referohen informacioneve të ndryshme mbi zonat.

Sipas **nenit 13**, zonat e mbrojtura të kategorive “Rezervë strikte e mbrojtur” dhe “Monumentet e natyrës” nuk do të ketë nënzona, por kanë vetëm një zonë buferike përreth tyre, ndërsa territori i zonës së mbrojtur brenda Parkut Natyror, Rezervës Natyrore të Menaxhuar dhe Peizazhit të Mbrojtur ndahet në nënzona dhe përfshin:

- nënzonën qendrore (NQ) – shkalla A dhe B - që ka si funksion parësor ruajtjen e biodiversitetit dhe sigurimin e një zone natyrore të pashqetësuar, ku përdoret shkalla e parë e mbrojtjes (strikte);
- nënzonat e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm (NPTQ) që kanë funksion ruajtjen parësore të biodiversitetit dhe sigurojnë një zonë natyrore pak të shqetësuar nga veprimtaritë tradicionale dhe ekoturistike, ku përdoret shkalla e dytë e mbrojtjes;
- nënzonat e rekreacionit (NR) - që kanë funksion ruajtjen e natyrës dhe të biodiversitetit në harmoni me zhvillimin e veprimtarive social-ekonomike e turistike,

të infrastrukturës për banorët e zonës dhe komunitetin e biznesit, ku përdoret shkalla e tretë e mbrojtjes;

- nënzonën buferike (NB)
- nënzonën e peizazhit dhe trashëgimisë kulturore (NPTK)

**Neni 47** e specifikon zonimin në mënyrë të ndryshme; zonimi i brendshëm miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave që shpall zonën e mbrojtur dhe mund të përmbajë:

- zonën qendrore,
- zonën e rekreacionit dhe të përdorimit tradicional dhe
- zonën e zhvillimit të qëndrueshëm

Në fakt, **neni 47** parashikon se “zonimi i brendshëm mund të përmbajë ...”, por fjala kyçe këtu është “mund”, ndërsa dispozita e detajuar e detyrueshme jepet në nenin 13. Më tej, akti nënligjor në zbatim të këtyre dispozitave (VKM 57/2019 “Për procedurat dhe modalitetet e zonave”) ka detajuar në mënyrë specifike nënzonat pikërisht siç parashikohet në nenin 13.

Nënzonimi brendshëm i një zone bëhet në përputhje me Planin e Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur, në bazë të kërkesave për mënyrën e zonimit të territorit të një zone të mbrojtur, të miratuar me udhëzim të ministrit.

**Neni 13:3** përcakton se: (a) në nënzonën qendrore, që ka si funksion ruajtjen tërësore të biodiversitetit dhe siguron një zonë natyrore të pashqetësuar, përdoret shkalla e parë e mbrojtjes; (b) Në nënzonat e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm, që kanë funksion ruajtjen parësore të biodiversitetit dhe sigurojnë një zonë natyrore pak të shqetësuar nga veprimtaritë tradicionale dhe ekoturistike, përdoret shkalla e dytë e mbrojtjes: dhe (c) Në nënzonat e rekreacionit, që kanë funksion ruajtjen e natyrës dhe të biodiversitetit në harmoni me zhvillimin e veprimtarive social-ekonomike e turistike, të infrastrukturës për banorët e zonës dhe komunitetin e biznesit), përdoret shkalla e tretë e mbrojtjes.

## 5.2 Veprimtaritë e lejuara dhe të ndaluara (të zbatueshme mbi të gjitha ZM-të)

**Nenet 33, 34 dhe 56 të Ligjit të ZM-ve** parashikojnë veprimtaritë që lejohen ose mund të jenë të lejueshme për t’u kryer në ZM.

Në zonat e mbrojtura mjedisore mund të zhvillohen veprimtari ekonomike, shoqërore, turistike, kërkimore-shkencore dhe çdo lloj veprimtarie tjetër e parashikuar në Planin e Menaxhimit dhe që nuk ndalohe shprehimisht nga ky ligj.

Në Planin e Menaxhimit, për secilën nënzonë, caktohen qartazi dhe në mënyrë të detajuar veprimtaritë e ndaluara dhe ato për të cilat kërkohet leje dhe/ose miratim i lëshuar nga administrata e zonës së mbrojtur.

Veprimtaritë e lejuara ekonomike duhet të jenë gjithmonë në përputhje me Planin e Menaxhimit dhe vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit. Përfshirë nga kërkesa për miratim paraprak bëjnë veprimtaritë ushtarake, të cilat mund të ushtrohen pasi të jenë pajisur me leje mjedisore.

**Tabela 1. Veprimtaritë e lejuara në të gjitha zonat e mbrojtura pas marrjes së lejes:**

<p>1. Veprimtaritë që lejohen të ushtrohen <b>në të gjitha zonat e mbrojtura mjedisore</b> pasi të jenë pajisur me miratimin paraprak nga autoritetet përgjegjëse përfshijnë:</p>	<p>2. Në zonat e mbrojtura <b>detare, liqenore dhe lumore</b> lejohen të ushtrohen veprimtaritë e mëposhtme pasi të jenë pajisur me miratimin paraprak:</p>	<p>3. <b>Pyjet</b> në zonat e mbrojtura mjedisore përjashtohen nga klasifikimi si pyje prodhuese.</p>	<p>4. Menaxhimi i <b>ujërave e pasurive ujore</b>, si dhe i pasurive të tjera, pronë publike dhe private, bëhen nga administrata e ZM-së dhe në përputhje me planin e menaxhimit të zonës.</p>
<p>Çdo veprimtari në përputhje me Planin e Menaxhimit;</p>	<p>Çdo veprimtari në përputhje me Planin e Menaxhimit;</p>	<p>Të gjitha ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin e ekosistemeve të ndryshme realizohen vetëm në rast se janë parashikuar në Planin e Menaxhimit ose vijnë si pasojë e emergjencave natyrore, sipas projektit teknik dhe me miratim të AKZM-së.</p>	<p>Në zonat e mbrojtura detare e bregdetare është i ndaluar peshkimi për qëllime tregtimi, referuar dispozitave të legjislativës në fuqi për peshkimin dhe akuakulturën. Peshkimi tregtar lejohet vetëm në zonat e mbrojtura detare e bregdetare, pjesë e kategorive IV, V dhe VI, pas miratimit me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së të kushteve që duhet të zbatohen peshkimi në këtë zonë.</p>

Monitorime të gjendjes mjedisore, të ekosistemit, të habitateve dhe të llojeve floristike e faunistike;	Monitorime të gjendjes mjedisore, të ekosistemit, të habitateve dhe të llojeve floristike e faunistike;	Ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin kryhen nga banorët e zonave të mbrojtura, me qëllim përballimin e nevojave të tyre për ngrohje, në bazë të miratimit paraprak nga AdZM-ja e të listës emërore të banorëve të zonës, të konfirmuar nga administratori i njësisë së qeverisjes vendore.	Me hyrjen në fuqi të Ligjit për ZM-të, peshkimi në zonat e mbrojtura detare dhe bregdetare dhe peshkimi në ujërat e brendshme, i cili rregullohet me dispozitat e legjisllacionit në fuqi për peshkimin dhe akuakulturën, përpara se të miratohet si veprimtari, merr miratimin me urdhër të ministrit. Në rastet kur veprimtaria është duke u kryer sepse është miratuar apo është kontraktuar më parë, rregullat do të përcaktohen në marrëveshjen midis subjektit që ushtron veprimtarinë e peshkimit dhe AdZM-së që mbulon zonën e mbrojtur detare a bregdetare, në bazë të objektivave të mbrojtjes së zonës, kërkesave të planit të menaxhimit të saj dhe lejes së dhënë për peshkimin.
<b>Ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin</b>	<b>Studimet kërkimore-shkencore, përfshirë ato në fushën e trashëgimisë kulturore;</b>	Nëse dhe kur këto pasuri janë pronë private, ato menaxhohen e përdoren nga pronari ose përdoruesi i ligjshëm vetëm në përputhje me planin e menaxhimit të zonës dhe me miratimin paraprak të administratës së ruajtjes së zonës.	
<b>Struktura në përputhje me përcaktimet e Planit të Menaxhimit në shërbim të aktiviteteve turistike</b>	<b>Ndërtime të përkohshme turistike, të lehta, sezonale dhe miqësore me mjedisin.</b>	Menaxhimi i pyllit dhe i pasurive pyjore, i ujërave e pasurive ujore, si dhe i pasurive të tjera, pronë publike dhe private, që ndodhen brenda një zone të mbrojtur, bëhen nga administrata e ruajtjes së zonës dhe në përputhje me Planin e Menaxhimit	

		të zonës. Administrata i ushtron këto veprimtari drejtpërdrejt, nëpërmjet komunitetit lokal dhe/ose një subjekti të autorizuar prej saj.
Çdo veprimtari tjetër në përputhje me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit.	Çdo veprimtari tjetër në përputhje me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit.	

Ndërsa **neni 51** parashikon se gjuetia është e ndaluar në të gjitha kategoritë e zonave të mbrojtura mjedisore, **nenet 48, 49, 50** parashikojnë më tej në mënyrë të detajuar se cilat veprimtari janë të ndaluara në secilën prej nënzonave, për të gjitha ZM-të ku janë të zbatueshme nënzonat:

**Tabela 2. Veprimtaritë e ndaluara në të gjitha Zonat e Mbrojtura**

Nënzonat	Veprimtaritë e ndaluara
<b>Zona Qendrore (neni 48)</b>	<p><b>Në nënzonën qendrore (niveлин A), janë të ndaluara veprimtaritë e mëposhtme:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>prerja e drurëve dhe e shkurreve;</li> <li>përdorimi i kimikateve dhe i plehrave kimike;</li> <li>ndërtime të çdo lloji;</li> <li>nxjerrja e mineraleve dhe e torfave;</li> <li>ndezja e zjarreve;</li> <li>kullotja, kalimi i kafshëve shtëpiake dhe ndërtimi i objekteve për mbajtjen e tyre;</li> <li>ngritja e objekteve çlodhëse, argëtuese dhe sportive;</li> <li>kalimi nëpër shtigje, me përjashtim të pronarit ose të përdoruesit të tokës;</li> <li>lëvizja me mjete motorike të çdo lloji, me përjashtim të makinave të administratës së ruajtjes së rezervatit dhe të zjarrfikësve;</li> <li>vojitja me barka, kanoe dhe mjete të tjera lundrimi;</li> <li>riprodhimi intensiv i llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie.</li> </ol> <p><b>Në nënzonën qendrore (niveлин B), janë të ndaluara veprimtaritë e mëposhtme:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>shfrytëzimi i tokës me teknologji intensive, me mjete dhe mënyra që shkaktojnë ndryshime rrënjësore në biodiversitet, në strukturën dhe funksionet e ekosistemeve ose që dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme sipërfaqen e tokës;</li> <li>neutralizimi i mbetjeve me origjinë jashtë territorit të Parkut kombëtar;</li> <li>shpërndarja e kafshëve dhe e bimëve jovendase, kur ato sjellin ndryshime në biodiversitetin e zonës;</li> <li>riprodhimi intensiv, me përjashtim të riprodhimeve shpëtuese;</li> <li>ndërtimi i rrugëve, autostradave, hekurudhave, zonave urbane, hidrocentraleve, linjave të tensionit të lartë dhe sistemeve të naftës dhe gazit me shtrirje të gjatë;</li> <li>larja dhe spërkatja e rrugëve me kimikate;</li> <li>mbjellja e pyjeve monokulturë;</li> <li>ndezja e zjarreve jashtë vendeve e pikave të caktuara;</li> <li>lëvizja e mjeteve të transportit jashtë rrugëve të caktuara;</li> </ol>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>j. nxjerrja e mineraleve, gurëve, torfave, me përjashtim të gurëve dhe rërës për mirëmbajtjen e parkut;</li> <li>k. veprimtari masive sportive, turistike, jashtë pikave të caktuara;</li> <li>l. organizimi i garave me automjete e motoçikleta;</li> </ul>
<b>Nënzona e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm (neni 49)</b>	<p><b>Në nënzonën e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm janë të ndaluara veprimtaritë e mëposhtme:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. ndryshimi i gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe ligatinave;</li> <li>b. depozitimi i kimikateve;</li> <li>c. lëvizja dhe parkimi i automjeteve jashtë rrugëve publike dhe vendeve të caktuara për parkim;</li> <li>d. mbledhja intensive e bimëve, mineraleve, gjetjeve paleontologjike dhe e gurëve;</li> <li>e. vendosja e stendave, tabelave të të dhënave, reklamave, shenjave dhe posterave, me përjashtim të atyre që japin të dhëna për objektivat e mbrojtjes së rezervatit;</li> <li>f. ngjitjet alpine, skitë, kampingjet dhe ndezja e zjarreve jashtë pikave e shtigjeve të caktuara;</li> </ul>
<b>Nënzona e rekreacionit (neni 50)</b>	<p><b>Në nënzonën e përdorimit të qëndrueshëm dhe të rekreacionit të një zone të mbrojtur mjedisore zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes, ku janë të ndaluara:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. mbjellja e pyjeve monokulturë;</li> <li>b. neutralizimi i mbetjeve dhe ndezja e zjarreve jashtë vendeve e pikave të caktuara;</li> <li>c. shpërndarja e kafshëve dhe e bimëve jovendase;</li> <li>d. ndërtimi i autostradave, i kanaleve lundruese dhe i zonave urbane;</li> <li>e. lëvizja me mjete transporti jashtë rrugëve dhe vendeve të caktuara.</li> </ul>

## **6. Qeverisja dhe forma e menaxhimit/administrimit**

Lidhur me format e administrimit të ZM-ve, zbatohen dispozitat e mëposhtme ekzistuese të Ligjit për ZM-të:

**Neni 8 i Ligjit të ZM-ve**, përcakton format e administrimit/menaxhimit mbi zonat e mbrojtura mjedisore duke parashikuar katër opsione të tilla: (i) shtetërore; (ii) private; (iii) bashkiake; (iv) të kombinuara. Forma e administrimit/menaxhimit për çdo zonë konkrete përcaktohet në vendimet e Këshillit të Ministrave që miraton krijimin e zonës, ndryshimin e statusit apo ndryshimin e sipërfaqes së saj, me propozim të Ministrisë pas marrjes së mendimit të komunitetit vendor, të pronarëve privatë dhe miratimit me shkrim të bashkisë përkatëse ku ndodhet zona.

Në çdo formë të administrimit, menaxhimi dhe ruajtja e zonës bazohet dhe zbaton të njëjtat parime, rregulla dhe kërkesa që janë të specifikuar në ligjet për ZM-të dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre.

**Nenet 37, 38, 39 dhe 40 të Ligjit për ZM-të (nën Kreun IV – Strukturat e Menaxhimit të ZM-ve),** rendisin dhe përcaktojnë institucionet pjesëmarrëse në menaxhimin e ZM-ve dhe përcaktojnë rolet dhe përgjegjësitë kryesore të këtyre institucioneve, përkatësisht në nivel shtetëror/të qeverisjes qendrore: Ministria (neni 37), AKZM-ja (neni 38) dhe AdZM-të (neni 39); dhe në nivel të qeverisjes vendore: bashkitë (neni 40).

**Neni 42 i Ligjit për ZM-të** ka të bëjë me Planet e Menaxhimit (PM) të ZM-ve dhe parashikon PM-ja hartohet nga AKZM-ja dhe miratohet nga Ministria për një afat 10-vjeçar, në bashkëpunim me palët e tjera të interesit, të tilla si ministritë e linjës, bashkitë, publikun e interesuar, OJQ-të që merren me mjedisin dhe me pronarët privatë, pronat e të cilëve shtrihen brenda territorit të ZM-së.

Gjatë hartimit të planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura merren parasysh objektivat dhe kërkesat e politikave, planeve dhe programeve sektoriale që lidhen me to dhe integrohen në vendimmarrjet kombëtare, rajonale e vendore që prekin zonat e mbrojtura. Ky nen parashikon gjithashtu elementet e detyrueshme të PM-së që përfshijnë ndër të tjera objektivat e menaxhimit të ZM-së si dhe mekanizmat dhe institucionin drejtues të ZM-së.

Struktura e planit të menaxhimit, përmbajtja e tij dhe kriteret e rishikimit duhet të miratohen me udhëzim të ministrit. Aktualisht, ekziston një udhëzim i tillë, por ai është miratuar në lidhje me Ligjin e vjetër për ZM-të.

**Neni 43 i Ligjit për ZM-të** parashikon se PM-të zbatohen nga AZM-të përkatëse. Ky nen parashikon gjithashtu se zbatimi i elementeve të planeve të menaxhimit mund të realizohet nga persona fizikë/juridikë, publikë ose privatë, vendas ose të huaj, shoqëria civile, duke zbatuar rregullat dhe procedurat e legjislacionit, në bazë të kriterëve teknike të miratuara me udhëzim të ministrit, referuar nenit 42, të këtij Ligjit për Zonat e Mbrojtura.

**Neni 46 i Ligjit për ZM-të** parashikon, ndër të tjera, se menaxhimi i pyllit dhe i pasurive pyjore, i ujërave e pasurive ujore, si dhe i pasurive të tjera, pronë publike dhe private, që ndodhen brenda një ZM-je, bëhen nga administrata e ruajtjes së zonës dhe në përputhje me planin e menaxhimit të zonës. AZM-ja i ushtron këto veprimtari drejtpërdrejt, nëpërmjet komunitetit lokal dhe/ose një subjekti të autorizuar prej saj. Nëse dhe kur këto pasuri janë pronë private, ato menaxhohen e përdoren nga pronari ose përdoruesi i ligjshëm vetëm në përputhje me PM-në dhe me miratimin paraprak të AZM-së.

**Neni 56 i Ligjit për ZM-të** parashikon, ndër të tjera, në zonat e mbrojtura veprimtaritë mund të ushtrohen vetëm pasi të jetë marrë më parë leja e mjedisit ose pasi të jetë marrë miratimi me shkrim i AZM-së, në rastet kur kjo kërkohet shprehimisht nga Ligji për ZM-të. AKZM-ja

dhe AdZM-ja hartojnë rregullore për vizitorët, e cila publikohet e shpallet në vende të dukshme të ZM-së.

### **7. Mbikëqyrja dhe koordinimi:**

**Neni 41 i Ligjit për ZM-të** parashikon se komitetet e menaxhimit (KM) ngrihen për të ndjekur zbatimin e planeve të menaxhimit në zonat e mbrojtura. KM-ja përbëhet nga bashkia/bashkitë, brenda territorit administrativ të të cilit/cilave ndodhet zona e mbrojtur, AKZM-ja, nga institucionet vendore që kanë lidhje direkte me to, si të bujqësisë, të turizmit, të infrastrukturës, shoqërisë civile, përfaqësues nga pronarët e pyjeve e kullotave që gjenden në zonat e mbrojtura. KM-ja funksionon në përputhje me një rregullore të vetë-miratur, ndërsa funksioni i Sekretariatit Teknik, i cili administron të gjitha dokumentet që pasqyrojnë punën e kryer nga Komiteti, kryhet nga AZM-ja. Me propozim të ministrit, Këshilli i Ministrave miraton me VKM detyrat dhe përgjegjësitë e Komiteteve Drejtuese të ZM-ve.

**VKM Nr. 593 e vitit 2005**, e miratur për Komitetet e Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore përcakton se Komiteti i menaxhimit ka përgjegjësitë dhe detyrat për:

- a) Mbikëqyrjen e ecurisë së zbatimit të planit të menaxhimit të zonës dhe të programeve që hartohen në mënyrë të hollësishme, sipas kërkesave të tij;
- b) Përfshirjen në procesin e hartimit të planit të menaxhimit të zonës dhe ndjekjen e zbatimit të elementeve të tij, për të siguruar përputhshmërinë e tij me strategjinë dhe planet vendore e sektoriale të zhvillimit, duke u kujdesur që këto të fundit të respektojnë kërkesat për mbrojtjen e zonës;
- c) Nxitjen e zhvillimit ekologjik të mjedisve përreth zonës, si rrjedhojë e zbatimit të planit, me qëllim ruajtjen e cilësisë së saj;
- d) Analizimin e kryerjes së detyrave dhe të funksioneve të administratës së zonave të mbrojtura, në funksion të zbatimit të planit të menaxhimit, si dhe të raporteve për të ardhurat dhe shpenzimet financiare që lidhen me zbatimin e planit;
- e) Rekomandimin për përcaktimin e drejtimit të investimeve në zonë;
- f) Miratimin e raportit vjetor të gjendjes së zonës së mbrojtur;
- g) Propozimin të ministri përgjegjës për mjedisin dhe AKZM-ja për ndryshime në planin e menaxhimit të zonës, zgjerimin e kufijve, si dhe masa shtesë për përmirësimin e cilësive të saj, kur këto mbështeten në studime të kryera dhe argumente mbi nevojën e ndryshimit. Në rast se propozimi përfshin një zonë që ka dhe vlera të trashëgimisë dhe



- peizazhit kulturor, propozimi duhet të marrë edhe miratimin e organeve kolegjiale vendimmarrëse të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
- h) Nxitjen e hartimit dhe të zbatimit të projekteve për përmirësimin e cilësive të zonës;
  - i) Ndjekjen e zbatimit të planit të menaxhimit të zonave të mbrojtura.

#### **8. Të ardhurat e ZM-ve dhe fondet buxhetore:**

Lidhur me të ardhurat e ZM-ve dhe fondet buxhetore, janë të zbatueshme dispozitat e mëposhtme:

**Neni 5 (6) i Ligjit për ZM-të** parashikon se kostot e ngritjes, ruajtjes dhe administrimit të sistemit kombëtar të zonave të mbrojtura mjedisore financohen nga Buxheti i Shtetit dhe donacionet.

**Neni 38 (5)/h i Ligjit për ZM-të** parashikon se AKZM-ja është përgjegjëse për menaxhimin financiar të rrjetit të zonave të mbrojtura.

**Neni 57 i Ligjit për ZM-të** ka të bëjë me burimet e financimit dhe përdorimin e tyre. Ai parashikon se menaxhimi i zonave të mbrojtura mjedisore financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme, duke përcaktuar se AKZM-ja është përgjegjëse për administrimin e të gjitha të ardhurave të realizuara nga aktiviteti ekonomik në territorin e zonave të mbrojtura mjedisore.

Rregullat e përdorimit të shërbimeve të ofruara nga ZM-të si dhe pagesa e tarifave dhe pagesave përkatëse përcaktohen me udhëzim të ministrit, me propozimin e AKZM-së.

Përrjashtim nga kjo dispozitë bëjnë rastet kur pjesë të zonave të mbrojtura administrohen nga institucionet në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, të cilat janë të shpallura zona të trashëgimisë kulturore.

**Neni 58 i Ligjit për ZM-të** përcakton kategoritë e të ardhurave të siguruara nga tarifat e paguara dhe rregullat për përdorimin e tyre. Më konkretisht, ky nen parashikon kategoritë e mëposhtme të të ardhurave:

- i. tarifat që paguajnë vizitorët e turistët që vizitojnë zonën;
- ii. tarifat që paguhen për ushtrimin e veprimtarive që kryhen në zonat e mbrojtura;
- iii. vlerat monetare të zhdëmtimeve që paguajnë dëmtuesit e zonës;
- iv. donacionet e ndryshme;

- v. tarifat që paguhen nga transporti në territoret e tyre; dhe
- vi. të ardhura të ndryshme jo të parashikuara në ligj.

Më tej, ky nen parashikon se të ardhurat e gjeneruara nga tarifrat në zonat e mbrojtura, masa dhe kriteret e përdorimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit. Përdorimi i këtyre të ardhurave nuk i nënshtrohet rregullave për prokurimin publik dhe duhet të përdoren për:

- vii. investimet në zonat e mbrojtura;
- viii. përballimin e shpenzimeve për punësime sezonale për aktivitete brenda zonave të mbrojtura;
- ix. hartimin e planeve të menaxhimit e inventarizimit të pyjeve, kullotave, florës e faunës së egër, të zjarreve;
- x. projektet e pyllëzimit, për përmirësimet, luftimin nga gërryerjet, shtigjet në zonat e mbrojtura;
- xi. luftimin e sëmundjeve e të dëmtuesve;
- xii. masat për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri;
- xiii. mbarështimin, ushqimin dhe sigurimin e kushteve të jetesës për faunën e egër;
- xiv. masat për parandalimin dhe luftimin e erozionit;
- xv. ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës brenda zonave të mbrojtura për komunikimin, pritat malore, gardhimet, ndërtesat;
- xvi. blerjet e mjeteve të komunikimit e transportit, mobilimin dhe për përmirësimin e kushteve të punës së AdZM-ve dhe punës në terren;
- xvii. publikimet, ndërgjegjësimin, edukimin dhe informimin e publikut të gjerë;
- xviii. rehabilitimin e habitateve, largimin dhe menaxhimin e specieve invazive të huaja;
- xix. mbështetjen e aktiviteteve tradicionale të komuniteteve lokale

**Neni 59 i Ligjit për ZM-të** krijon Fondin e Veçantë për ZM-të me fondet e siguruara nga të ardhurat dhe nga kontributi i donatorëve, i cili përdoret me miratim të ministrit për përballimin e emergjencave, për rehabilitimin e pasojave të zjarreve apo të përmytjeve, të fatkeqësive natyrore, të infeksioneve në bimë a në kafshët e egra për zbutjen e efekteve

negative të ndryshimeve klimatike në zonat e mbrojtura për ndërhyrjet e detyrueshme ndaj llojeve të huaja.

Masa e Fondit e Veçantë për Zonat e Mbrojtura mjedisore, burimet e krijimit dhe rregullat e përdorimit të tij miratohen me VKM, me propozim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat.

Tabela 3 më poshtë, jep në hollësi dispozitat ligjore për planifikimin, përcaktimin dhe shpenzimin dhe autoritetet përkatëse për secilën kategori të të ardhurave.

**Tabela 3: Tarifat dhe administrimi**

<b>Kategoria e të ardhurave (Neni 58:2)</b>	<b>Legjislati ekzistues – autoritetet</b>
Tarifat që paguajnë vizitorët e turistët që vizitojnë zonën; tyre	<p><b>Këshilli i Ministrave</b> – Sikurse parashikohet në nenin 58 (4) të Ligjit për ZM-të</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përcakton në detaje llojin/nënkategorinë</li> <li>- Vendosi për masën e tyre</li> <li>- Vendosi për kriteret për përdorim</li> </ul> <p><b>Ministri</b> – Sikurse parashikohet në nenin 57 (4)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendosi për rregulloren për përdorimin e shërbimeve të ofruara nga ZM-të</li> </ul> <p><b>AKZM-ja</b> – sikurse parashikohet në nenin 38 (5)/h, nenin 57 (2) dhe nenin 58 (3) të Ligjit për ZM-të; VKM 1156/2020; VKM 302/2019; VKM 102/2015</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendosi për parashikimin vjetor të të ardhurave</li> <li>- Vendosi për shpërndarjen e të ardhurave për shpenzimet vjetore të projekteve të ZM</li> </ul>
tarifat që paguhen për ushtrimin e veprimtarive që kryhen në zonat e mbrojtura;	
tarifat që paguhen nga transporti në territoret e zonave të mbrojtura	
vlerat monetare të zhdëmtimeve që paguajnë dëmtuesit e zonës;	<p><b>Këshilli i Ministrave</b> – Sikurse parashikohet në nenin 58 (3) dhe nenin 68 (3) të Ligjit për ZM-të</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përcakton në detaje llojin/nënkategorinë</li> <li>- Vendosi për masën e tyre</li> <li>- Vendosi për kriteret për përdorim</li> </ul> <p><b>AKZM-ja</b> – sikurse parashikohet në VKM-në e 2020-ës; VKM-në Nr. 1156 të 2020-it; VKM-në Nr. 102 të 2015-ës</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendosi për shpërndarjen e të ardhurave për shpenzimet vjetore të projekteve të ZM</li> </ul>

donacionet e ndryshme dhe të ardhura jo të parashikuara në Ligjin për ZM-të.	<b>AKZM-ja</b> – sikurse parashikohet në nenin 38 (5)/h, nenin 57 (2) dhe nenin 58 (3); VKM Nr. 1156 të 2020-ës; VKM Nr. 102 të 2015-ës - Vendos për shpërndarjen e të ardhurave për shpenzimet vjetore të projekteve të ZM
--	--

## 9. Monitorimi dhe inspektimi

**Neni 60 i Ligjit për ZM-të** parashikon që AKZM-ja është përgjegjëse për drejtimin, organizimin, monitorimin e zbatimit të planit, mbikëqyrjen periodike vjetore, rezultatet e monitorimit të tij, si dhe për administrimin e publikimin në faqen zyrtare elektronike të saj të të dhënave përkatëse. Në zbatimin e programeve të monitorimit, AKZM-ja mund të angazhojë institucione kërkimore-shkencore, si dhe subjekte publike ose private, të specializuara në këtë fushë, në bazë të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

Monitorimi i veprimtarisë së zonave të mbrojtura mjedisore ushtrohet nga administrata rajonale e zonave të mbrojtura dhe nga subjektet e angazhuara prej saj në monitorim, si edhe nga subjektet që kryejnë veprimtari të lejuar në zonat e mbrojtura e, vetëmonitorojnë aktivitetin që ushtrojnë, sipas kërkesave të specifikuara nga AKZM-ja në zbatim të programit të monitorimit të zonës dhe ia njoftojnë AdZM-së përkatëse të dhënat që dalin nga vetëmonitorimi.

**Neni 66 i Ligjit për ZM-të** përcakton përgjegjësitë e inspektimit, të cilat realizohen nga Inspektorati i Policisë Pyjore dhe AZM-të. Të dyja këto i raportojnë AKZM-së.

## 10. Burimet njerëzore

VKM Nr. 102 e vitit 2015 për AKZM-në dhe AdZM-të parashikon se regjimi i punësimit të personelit të AKZM-së është nën kuadrin ligjor të Shërbimit Civil, ndërsa punonjësit e AKZM-së (përfshirë të punësuarit e përkohshëm) janë nën regjimin e Kodit të Punës. Kriteret e rekrutimit dhe përshkrimet e vendeve të punës miratohen nga Ministri, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së.

#### IV. GJETJET KRYESORE TË SHQYRTIMIT DHE ANALIZA E MANGËSIVE

Më poshtë jepen analizat e hollësishme dhe shpjegimi i gjetjeve dhe mangësive në Ligjin për ZM-të, që kanë nevojë të adresohen me amendime, të cilat trajtohen në mënyrë të strukturuar, të organizuar sipas temave të trajtuara, dispozitave ligjore ekzistuese dhe nevojës për ndërhyrje me amendime të ligjit.

##### 1. *Ligji duhet amenduar për saktësimin e zonimit dhe aktiviteteve*

Dispozitat e lidhura me zonimin dhe llojet e nënzonave, duhet të rishikohen për të shmangur mungesën e konsistencës dhe për të ofruar më shumë qartësi

Neni 13 përshkruan 5 nënzona: (nënzonën qendrore, nënzonat e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm, nënzonat e rekreacionit, nënzonën buferike, nënzonën e peizazhit dhe trashëgimisë kulturore), ndërsa neni 47 përshkruan tri zona (zonën qendrore, zonat e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm dhe zonën e zhvillimit të qëndrueshëm).

Dispozitat që lidhen me aktivitetet e ndaluara, të lejuara dhe ato që duhet të pajisen me leje, duhet të rishikohen, mundësisht të kombinohen në një nen të vetëm, për të shmangur mospërputhjet dhe për të siguruar më shumë qartësi për veprimtaritë e lejuara dhe veprimtaritë që kanë nevojë për leje.

Ne faqe 38 te Udhëzimit të IUCN: Thomas, Lee and Middleton, Julie, (2003). Guidelines for Management Planning of Protected Areas. IUCN Gland, Sëitserland and Cambridge, UK. 79pp. parashikohet se *“Management Plans for protected areas may identify different ‘management zones”*

Plani i Menaxhimit të ZM-ve është dokumenti kryesor që përshkruan se cilat veprimtari ekonomike, sociale, turistike, kërkimore shkencore dhe çdo veprimtari tjetër, nëse nuk ndalohen shprehimisht nga ky ligj, mund të kryhen në (çdo kategori) të zonave të mbrojtura. Veprimtaritë që mund të ushtrohen vetëm pas marrjes të lejes mjedisore, ose pas miratimit me shkrim të institucionit përgjegjës për zonën e mbrojtur, nuk janë të specifikuar. Pra, është e nevojshme që të detajohen më mirë veprimtaritë e ndaluara dhe ato të lejuara me marrjen e lejes nga AKZM-ja.

Për më tepër, leja mjedisore është një instrument që mund të lejojë që në zona të ndryshme të mbrojtura të ndërmerren disa veprimtari, duke përfshirë ato që mund të jenë potencialisht të dëmshme për objektivat e menaxhimit të ZM-së. Për rrjedhojë, nevojitet më shumë qartësi për llojin e veprimtarive të lejuara edhe në fushëveprimin e lejes mjedisore.

Në nënzonën qendrore të ZM-së ndalohet, ndër të tjera, ndryshimi i gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe ligatinave. Nënzona qendrore e zonës së mbrojtur (shkalla e parë e mbrojtjes) nëndahet në nivelin A dhe nivelin B, por nuk bëhet një dallim i qartë midis këtyre dy niveleve.

Niveli i dytë i mbrojtjes (nënzona e përdorimit tradicional dhe zhvillimit të qëndrueshëm) është niveli i mbrojtjes që synon kryesisht ruajtjen e biodiversitetit duke siguruar një zonë natyrore pak të trazuar me aktivitete tradicionale dhe ekoturistike.

Në nënzonën e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm ndalohen, ndër të tjera, ndryshimi i gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe ligatinave, çfarë do të thotë që ndërtimi i hidrocentraleve dhe i projekteve të tjera të mëdha infrastrukturore duhet të ndalohet shprehimisht edhe në zonën e mbrojtur të nivelit të dytë.

## **2. Ligji duhet të mishërojë shprehimisht modelet e qeverisjes të njohura nga IUCN**

Për të pasur një kuptim më të mirë të arsytimit që qëndron pas ndryshimeve të propozuara, në lidhje me qeverisjen dhe menaxhimin e ZM-ve, mund të jetë me vlerë që të eksplorohej konceptet e qeverisjes së ZM-ve, llojet e qeverisjes dhe lidhja me menaxhimin e ZM-ve, të zhvilluara nga udhëzimet e praktikave më të mira të IUCN-së.

Në kontekstin e zonave të mbrojtura, Udhëzimet e praktikave më të mira të IUCN-së e përkufizojnë qeverisjen si: *“ndërveprimet ndërmjet strukturave, proceseve dhe traditave që përcaktojnë se si ushtrohet pushteti, se si merren vendimet për çështjet me interes publik dhe se si qytetarët ose palët e tjera të interesit e thonë fjalën e tyre”*. Mënyra e realizimit të qeverisjes përcaktohet përmes kornizave ligjore dhe politikave, strategjive dhe planeve të menaxhimit. Ato përfshijnë mënyrën e organizimit për realizimin e politikave dhe planeve dhe monitorimin e performancës. Qeverisja mbulon rregullat e vendimmarrjes, duke përfshirë kush ka akses në informacion dhe merr pjesë vetë në procesin e vendimmarrjes, si dhe vendimet që merren.<sup>1</sup>

Menaxhimi i çdo zone të mbrojtur përfshin aktorë, instrumente dhe kompetenca të ndryshme dhe mishërohet në nivele të shumta rregullash dhe vendimmarrjesh, duke filluar nga kuadret e politikave ndërkombëtare deri te marrëveshjet buxhetore kombëtare, nga

---

<sup>1</sup> Burimi: Borrini-Feyerabend, G., A. Kothari and G. Oviedo. 2004. *Indigenous and Local Communities and Protected Areas: Towards Equity and Enhanced Conservation. Best Practice Protected Area Guidelines Series No. 11.* Gland and Cambridge: IUCN.

planet vendore të përdorimit të tokës, deri te vendimet e përditshme që kanë ndikim mbi jetesën e njerëzve që banojnë brenda dhe pranë zonave të mbrojtura.

Rrjedhimisht, vendimet e qeverisjes merren për çështje të ndryshme nga institucione të ndryshme: për shembull, një institucion mund të krijojë zonën e mbrojtur, një tjetër agjenci apo institucion mund të vendosë për zonimin dhe rregulloret përkatëse dhe një agjenci apo institucion i tretë mund të zbatojë ligjet për të drejtat e njeriut ose legjislacionin e specieve në rrezik.

Ndërkohë që ndikimet ligjore, zakonore dhe social-politike ndryshojnë shumë, vendimet kryesore të qeverisjes së një zone të mbrojtur janë ato që lidhen më drejtpërdrejt me biodiversitetin, burimet natyrore dhe njerëzit. Këto vendime përfshijnë:<sup>2</sup>

- vendimi se territori ose zona detare do të “ruhet” dhe qartësimi i shtrirjes dhe perimetrit të përgjithshëm të territorit ose zonës;
- përcaktimi i qëllimit afatgjatë (vizionit), objektivit kryesor të menaxhimit (dhe kategorisë së menaxhimit sipas IUCN-së) dhe se si këto do të lidhen me jetesën dhe zhvillimin lokal;
- krijimi i një sistemi zonimi për zonën, duke përfshirë ndoshta rregulla të ndryshme të qeverisjes dhe menaxhimit;
- sanksionimi i një plani dhe/ose rregullave të menaxhimit, vendimi se kush do t'i zbatojë ato dhe sigurimi i burimeve njerëzore dhe financiare për të ndjekur objektivat e menaxhimit dhe/ose për të zbatuar rregullat;
- përcaktimi i mënyrës se si do të bëhet monitorimi, vlerësimi dhe përshtatja e planit të menaxhimit dhe procesit të zbatimit duke pasur parasysh rezultatet (menaxhimi përshtatës);
- përcaktimi i mënyrës se si duhet respektuar dhe zbatuar shteti i së drejtës dhe legjislacioni ndërkombëtar më i gjerë (duke përfshirë të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve indigjenë nëse ka) brenda dhe përreth zonës së mbrojtur.

### ***Llojet e qeverisjes përkundrejt formave të menaxhimit***

---

<sup>2</sup> Borrini-Feyerabend, G., N. Dudley, T. Jaeger, B. Lassen, N. Pathak Broome, A. Phillips and T. Sandwith (2013). *Governance of Protected Areas: From understanding to action. Best Practice Protected Area Guidelines Series No. 20, Gland, Switzerland: IUCN; pp. 10 – 11.*

Qeverisja dhe menaxhimi janë të lidhura ngushtë, por sikurse tregohet nga Tabela 4<sup>3</sup> më poshtë, ato kanë karakteristika të dallueshme nga njëra-tjetra. Ky dallim ndihmon për të sqaruar se me çfarë ka të bëjë qeverisja.

**Tabela 4: Cili është dallimi midis menaxhimit dhe qeverisjes?**

<b>Menaxhimi</b>	...ka te beje me...	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>çfarë bëhet</b> për të arritur objektivat e përcaktuara</li> <li>- <b>mjetet dhe veprimet</b> për arritjen e këtyre objektivave</li> </ul>
<b>Qeverisja</b>	...ka te beje me...	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>kush vendos</b> se cilat janë <b>objektivat</b>, <b>çfarë duhet bërë</b> për t'i ndjekur ato dhe me <b>çfarë mjetesh</b></li> <li>- si merren ato vendime</li> <li>- kush ka <b>kompetenca, autoritet</b> dhe <b>përgjegjësi</b></li> <li>- kush është <b>llogaridhenes</b> (ose duhet) të <b>jape llogari</b></li> </ul>

IUCN-ja ka identifikuar lloje të ndryshme të qeverisjes për të ndihmuar për kuptimin, planifikimin dhe regjistrimin e zonave të mbrojtura. Llojet e qeverisjes përcaktohen në bazë të "*kush ka autoritetin dhe përgjegjësinë e menaxhimit dhe mund të jetë llogaridhënësi*" për një zonë të mbrojtur të caktuar.<sup>4</sup>

Edhe pse regjimi i qeverisjes së ZM-ve dhe sistemeve të ZM-ve ndryshojnë shumë në mbarë botën, si IUCN-ja ashtu edhe Konventa e Diversitetit Biologjik (KDB), njohin legjitimitetin e një sërë regjimesh të qeverisjes për zonat e mbrojtura, të përcaktuara në bazë të asaj se kush e ka autoritetin, përgjegjësinë dhe mund të jetë llogaridhënësi lidhur me vendimet kyçe për zonat e mbrojtura (shih Tabelën 5 më poshtë).<sup>5</sup>

**Tabela 5: Llojet e qeverisjes së IUCN-së për zonat e mbrojtura**

<sup>3</sup> Burimi: Borrini-Feyerabend, G., "Governance of protected areas: innovations in the air", *Policy Matters*, 12: 92-101, 2003.

<sup>4</sup> Burimi: Borrini-Feyerabend, G. 2004. "Governance of protected areas, participation and equity", pp. 100–105 in *Secretariat of the Convention on Biological Diversity, Biodiversity Issues for Consideration in the Planning, Establishment and Management of Protected Areas and Networks. Technical Series no. 15. Montreal: SCBD.*

<sup>5</sup> IUCN, 2004; CBD Decision VII.28, Kuala Lumpur, 2004; SCBD, 2004; Dudley, 2008; CBD Decision X.31, Nagoya, 2010.



Lloji i Qeverisjes	Nënlojet
<b>Lloji A. Qeverisja nga shteti</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ministritë ose agjencitë përgjegjëse kombëtare apo federale</li> <li>• Ministritë ose agjencitë territoriale përgjegjëse (p.sh., në nivel rajonal, qarku, bashkie)</li> <li>• Menaxhimi i deleguar nga qeveria (p.sh. te një OJQ)</li> </ul>
<b>Lloji B. Qeverisja e përbashkët</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qeverisja ndërkufitare (marrëveshjet formale ndërmjet një ose më shumë shteteve ose territoreve sovrane)</li> <li>• Qeverisja bashkëpunuese (përmes mënyrave të ndryshme në të cilat aktorë dhe institucione të ndryshme punojnë së bashku)</li> <li>• Qeverisja e përbashkët (bordi pluralist ose organ tjetër qeverisës shumëpalesh)</li> </ul>
<b>Lloji C. Qeverisja private</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zonat e ruajtuara të krijuara dhe të drejtuara nga: <ul style="list-style-type: none"> <li>✕ pronarët individualë të tokave</li> <li>✕ organizatat jofitimprurëse (p.sh., OJQ-të, universitetet)</li> <li>✕ organizatat fitimprurëse (p.sh., shoqëritë tregtare pronare te tokave)</li> </ul> </li> </ul>
<b>Lloji D. Qeverisja nga popujt autoktonë dhe bashkësitë lokale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Territorët dhe zonat e konservuara të komuniteteve indigjenë – të krijuara dhe të drejtuara nga ata</li> <li>• Zonat dhe territorët e konservuara nga komunitetet vendase – themeluar dhe drejtuar nga komunitetet lokale</li> </ul>

Sipas Udhëzimeve të IUCN-së për Zbatimin e Kategorive të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura, zonat e mbrojtura të të gjitha kategorive mund të qeverisen (dhe të jenë në pronësi) nga agjencitë qeveritare, OJQ-të, komunitetet, popujt indigjenë, kompanitë dhe palët private, qoftë individualisht prej secilës prej tyre, ose në kombinim.<sup>6</sup>

Për më tepër, Udhëzimet e IUCN-së mbi Legjislacionin e Zonave të Mbrojtura e bëjnë të qartë se qeverisja është një aspekt i veçantë nga pronësia,<sup>7</sup> "edhe pse pronësia është e rëndësishme kur merren parasysh qasjet e duhura të qeverisjes për një vend të caktuar." Në fakt, zonat e mbrojtura të çdo lloji qeverisje mund të përfshijnë një sërë të drejtash mbi pronësinë, të tilla si ato që rrjedhin nga bashkepronësia, delegimi, dhënia me qira dhe marrëveshjet e përdorimit.

Gjatë dekadave të fundit, i është kushtuar gjithnjë e më shumë vëmendje nevojës për të zgjeruar sistemet formale të zonave të mbrojtura përtej zonës së mbrojtur në pronësi të shtetit, ose të kontrolluar nga shteti.

Ky trend është motivuar nga rritja e shqetësimeve midis shkencëtarëve dhe menaxherëve të ruajtjes sa i takon shkallës alarmante të humbjes së biodiversitetit në mbarë botën dhe nevojës kritike për të rritur mbulimin e sistemeve të zonave të mbrojtura për të ndihmuar për arritjen e objektivave të biodiversitetit. Është marrë parasysh, në veçanti, potenciali për

<sup>6</sup> Dudley, N. (ed.) (2008). *Guidelines for Applying Protected Area Management Categories*. Gland, Switzerland: IUCN. Dudley, N., Shadie, P. and Stolton, S. (2013). *Best Practice Protected Area Guidelines Series No. 21*. Gland, Switzerland: IUCN

<sup>7</sup> Lausche, Barbara. (2011). *Guidelines for Protected Areas Legislation*. IUCN, Gland, Switzerland.

njohjen e zonave të konservuara vullnetarisht dhe organizimet për qeverisjen e tyre si qasje të reja të qeverisjes për zonat e mbrojtura që mund të njihen si pjesë e sistemeve formale të zonave të mbrojtura. Këto qasje po promovohen dhe po njihen gjithnjë e më shumë nga komuniteti ndërkombëtar i ruajtjes dhe shumë qeveri kombëtare.<sup>8</sup>

Marrëdhënia midis llojit të qeverisjes dhe kategorisë së menaxhimit jepet në Matricën e Zonës së Mbrojtur të IUCN-së, e cila ndihmon në veçanti për vizualizimin e kombinimeve të kategorisë së menaxhimit dhe llojit të qeverisjes që mund të jenë të zbatueshme një sistemi zonash të mbrojtura.<sup>9</sup>

Për qëllimin e këtij raporti, Matrica u përdor si mjet për të kryer një ushtrim që synon të mendojë dhe klasifikojë kombinimet e kategorisë së menaxhimit dhe llojit të qeverisjes që ekzistojnë aktualisht dhe mund që të ekzistojnë në sistemin e zonave të mbrojtura të Shqipërisë, të mundësuar nëpërmjet këtyre ndryshimeve ligjore. Rezultatet e ushtrimit jepen në Shtojcën 2 të këtij Raporti.

### **Qeverisja si vazhdimësi**

Ndërsa shekulli i 21-të vazhdon dhe qeveritë përballen me rritje të kufizimeve të burimeve për blerjen e tokës së re për ruajtje, gjithnjë e më shumë do të duhet të merren parasysh qasjet e reja të qeverisjes së zonave të mbrojtura, në mënyrë që ato që të ndihmojnë për përmbushjen e qëllimeve të biodiversitetit dhe ruajtjen e funksioneve thelbësore të ekosistemeve.

Dhënia jetë e këtyre nismave në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme do të ndihmohet shumë nga dispozitat mbështetëse në ligjin për zonat e mbrojtura ose legjislacionin tjetër përkatës. Këto instrumente duhet të japin fleksibilitet për të shqyrtuar dhe rishikuar format e qeverisjes dhe të menaxhimit, pasi kapacitetet dhe nevojat ndryshojnë me kalimin e kohës.<sup>10</sup>

---

<sup>8</sup> Lausche, Barbara. (2011). *Guidelines for Protected Areas Legislation*. IUCN, Gland, Switzerland.

<sup>9</sup> Dudley, N. (ed.) (2008). *Guidelines for Applying Protected Area Management Categories*. Gland, Switzerland: IUCN. Dudley, N., Shadie, P. and Stolton, S. (2013). *Best Practice Protected Area Guidelines Series No. 21*. Gland, Switzerland: IUCN; pp.27

<sup>10</sup> Lausche, Barbara. (2011). *Guidelines for Protected Areas Legislation*. IUCN, Gland, Switzerland




Figura 1 – Format e qeverisjes së ZM-ve dhe opsionet e autoriteteve të ZM-ve lidhur me përfshirjen e mbajtësve të të drejtave dhe palëve të interesit.

### 3. Ligji i ZM-ve duhet të zgjerojë opsionet lidhur me mekanizmat e financimit

Sistemet e zonave të mbrojtura kërkojnë financim të qëndrueshëm, i cili përfshin një sërë instrumentesh dhe mekanizmesh novatorë të zbatuar edhe nga institucione që shpesh nuk janë përgjegjëse për zonat e mbrojtura.

Ekziston një dakordësi e gjerë midis profesionistëve të ruajtjes së natyres në mbarë botën se shpenzimet aktuale për zonat e mbrojtura janë jashtëzakonisht të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e zonave të mbrojtura ekzistuese dhe për të zgjeruar mbulimin për të arritur qëllimet ndërkombëtare për ruajtjen e biodiversitetit. Dy mekanizmat financiarë kryesorë kanë qenë mjete tradicionale të mbështetjes për zonat e mbrojtura dhe ato mbeten shumë të rëndësishme për të ardhmen e sistemeve të zonave të mbrojtura. Së pari, buxhetet e qeverisë kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë thelbësore për financimin bazë. Së dyti, të ardhurat e mbledhura nga zonat e mbrojtura, veçanërisht nga turizmi dhe tarifatat e tjera të përdoruesve, janë të rëndësishme për t'iu kthyer sistemit të zonave të mbrojtura për t'u përdorur prej tij.

Gjithashtu, gjithnjë e më shumë po eksploroheh mekanizma të rinj dhe novatorë financiarë për zonat e mbrojtura për forcimin e potencialit të tyre për të forcuar, zgjeruar dhe mbështetur bazën e financimit. Legjislacioni për zonat e mbrojtura duhet të njohë gamën e plotë të opsioneve financiare që mund të jenë të realizueshme në juridiksionin e përfshirë. Mekanizmat e rinj financiarë zakonisht janë në juridiksionin e kuadreve të tjera ligjore, kryesisht të lidhura me politikën fiskale. Aty ku është e mundur, duhet të jetë e qartë se kompetencën për të percaktuar përdorimin e burimeve financiare duhet ta ketë autoriteti i menaxhimit të zonës së mbrojtur. Në këtë kontekst, mund të autorizohen për përdorim një mori mekanizmesh, duke përfshirë pranimin e donacioneve të drejtpërdrejta, ndarjen e kostove dhe përfitimeve dhe zhvillimin e qasjeve të bazuara në treg për të gjeneruar burime për fondet e veçanta të ruajtjes.<sup>11</sup>

#### **4. Ligji i ZM duhet përfaruar me Direktivat e BE-së dhe saktësuar në çështje teknike**

Ligji aktual i zonave të mbrojtura ka nevojë për një rishikim tërësor e sidomos në frymën e përafrimit me Direktivat Europiane të Habitave dhe të Shpendëve.

Po kështu ligji ka nevojë për:

- rishikim e saktësim të përkufizimeve,
- saktësim të formës së kombinuar të administrimit/menaxhimit të një ZM-je,
- saktësim të hapave për shpalljen e ZM-ve,
- sqarim të terminologjisë lidhur me planin specifik, planin e administrimit të rrjetit ekologjik dhe planin kombëtar të ZM-ve,
- sqarim në lidhje me nevojën ose jo të ndërmarrjes së vlerësimit të ndikimit në mjedis apo të një vlerësimi tjetër në rast të shpalljes së Zonës së Mbrojtur,
- rishikim me qëllim forcimin e rregullave për heqjen apo ndryshimin (reduktimin) e sipërfaqes dhe statusit të Zonës së Mbrojtur,
- përshtatjes më të mirë të sistemit tonë të nënzonimit me atë të IUCN-së,
- shtim të kriterëve për zonat e mbrojtura me interes kombëtar,
- shmangie të përsëritjeve dhe përplasjeve brenda vetë ligjit

---

<sup>11</sup> Lausche, Barbara. (2011). *Guidelines for Protected Areas Legislation*. IUCN, Gland, Switzerland

## V. SHPJEGIM ANALITIK I NDRYSHIMEVE TË PROPOZUARA

Ligji ekzistues “Për zonat e mbrojtura” i Shqipërisë, përveç mungesës së përkufizimeve dhe dispozitave të qarta për qeverisjen, menaxhimin, si dhe për rregullimet institucionale për qeverisjen dhe menaxhimin e ZM-ve, paraqet edhe një sërë nevojash për përmirësime e saktësime me natyrë teknike, të cilat adresohen në mënyrë analitike në vijim.

**Neni 1** i kombinuar me **Nenin 4**, kërkon rishikim për të përfshirë dhe parime të tjera të sugjerura na IUCN sikurse: (a) zbatimi i parimit të parandalimit në vendimmarrje, veçanërisht kur pasojat mund të jenë të pakthyeshme; (b) vendimmarrje të informuara dhe të bazuara në shkencë për ruajtjen dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura; (c) akses në kohë në informacione të sakta dhe relevante publike në lidhje me vendimet që merren në konsideratë nga qeveria në mënyrë që të sigurohet një pjesëmarrje domethënëse he (d) barazia sociale dhe drejtësia në kontekstin e ruajtjes dhe menaxhimit të zonave të mbrojtura në mënyrë që kostot dhe përfitimet të ndahen në mënyrë të drejtë.

**Neni 3** ka nevojë për rishikim për të saktësuar përkufizimet mbi AKZM, për të përfaruar më mirë termat me ato të Direktivës së Habitaveve, për të sqaruar pronësinë apo administrimin e Kurorës së Gjelbër, Parkut Natyror Bashkiak, përdorimin ose jo të zonës buferike në kategori të ndryshme nga Monumenti i Natyrës, përcaktimin e duhur të zonave me interes për Komunitetin Europian mbeshetur edhe në Direktivën e Shpendëve.

Në **Nenin 3**, pika 10 ka nevojë për rifomulim, në kuadër të harmonizimit dhe përputhjes me nenin 1 (g) të Direktivës së Habitaveve në lidhje me “Llojet me interes për komunitetin europian”; pika 11 ka nevojë për rifomulim, në kuadër të harmonizimit dhe përputhjes me nenin 1 (h) të Direktivës së Habitaveve, në lidhje me “Llojet prioritare”; pika 31 ka nevojë për rifomulim, në kuadër të harmonizimit dhe përputhjes me nenin 1 (k) të Direktivës së Habitaveve, në lidhje me përkufizimin “Zonë me interes për Komunitetin Europian”; në pikat 14 dhe 15, termi “që janë pronë e bashkive”, duhet të zëvendësohet me termin “që janë në administrim të bashkive”. Kjo sepse, termi “pronë” e kufizon përgjegjësinë e Bashkive vetëm në pasuri që është e regjistruar si pronë e tyre, ndërsa përgjegjësia e Bashkisë shtrihet edhe mbi prona të tjera (qoftë edhe të pa regjistruara, me pronar të panjohur, privat, etj.)

**Neni 3**, gjithashtu duhet rishikuar në përkufizimet për AKZM, AdZM, i kombinuar me **nenet 38 dhe 39**, në mënyrë që të lejojë që Ligji për ZM-të të prezantojë konceptin e autoritetit menaxhues për zona individuale, pra menaxhim individual [Autoriteti i Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur (AMZM)], si dhe opsioni që ky autoritet individual menaxhues të mund të ushtrohet edhe nga një ent i veçantë (entitete publike të krijuara ad-hoc, ose subjekte të tjera ligjore), për ti hapur rrugë menaxhimit të deleguar.

**Neni 6**, ka nevojë për rishikim, me qëllim përafrimin dhe saktësimin e terminologjisë si me Direktivën e Habitave dhe me Direktivën e Shpendëve, duhet ndryshuar pika (ii) e gërmës “c” si vijon: “ii) zonat me interes për Komunitetin Europian (SCIs), ku bëjnë pjesë zonat e veçanta të ruajtjes të habitave dhe të shpendëve (përkatësisht SACs dhe SPAs);”

Në gjendjen aktuale, akronimet e përdorura nuk përputhen me terminologjinë e Direktivave në fjalë, të cilat në fakt përcaktojnë:

SCI – Sites of Community Importance (sipas Direktivës së Habitave)

SAC – Special Areas of Conservation (sipas Direktivës së Habitave)

SPA – Special Protection Areas (sipas Direktivës së Shpendëve).

**Neni 7**, për pikën “a” të pg.2, ka vend për rishikim në drejtim të specifikimit të kategorizimit sipas Ligjit Nr.8743, datë 22.2.2001, i ndryshuar me ligjin nr. 9558/2006 për pronat e paluajtshme të shtetit, i cili i ndan pronat shtetërore në prona shtetërore publike dhe jo-publike.

**Neni 8** parashikon ndër format e administrimit/menaxhimit të zonave të mbrojtura edhe atë të kombinuara. Praktika tregon se kjo formë nuk funksionon për shkak të konflikteve institucionale, zbatimit jo koherent të ligjit nga institucione të ndryshme, konfliktit për të ardhurat etj. Besojmë se autoriteti menaxhues i zonës së mbrojtur duhet të jetë i vetëm dhe jo i dyzuar në mënyrë që të drejtat, detyrat, përgjegjësië dhe llogaridhënia të mos jenë kolegjiale por të parcaktuara qartësisht, duke u parashikuar edhe mundësia e menaxhimit të deleguar për zgjerimin e modeleve të qeverisjes drejt llojeve më të decentralizuara dhe gjithëpërfshirëse të administrimit.

**Neni 9** ka nevojë për zgjerim të përfshirjes së palëve të interesit. Jo vetëm bashkitë por edhe palë të tjera të interesuara përfshirë komunitetin, OJF-të, institucionet akademike etj.

**Neni 10** ka nevojë për sistemim për efekt koherence të renditjes së paragrafëve, duke saktësuar terminologjinë dhe duke përcaktuar saktë kufijtë diskrecionalë të vendimit për shpalljen e ZM. Gjithashtu ka nevojë për qartësim të hapave për shpalljen e ZM-ve, terminologjisë lidhur me planin specifik, planin e administrimit të rrjetit ekologjik dhe planin kombëtar të ZM-ve, ndryshimit të kërkesës për VNM gjatë procesit të shpalljes së një Zone të re të mbrojtur,

**Neni 11** kërkon rishikim të kriterëve të shpalljes së zonës së mbrojtur për qartësim të termit “prekshmëri ekologjike” dhe përfshirje të llojeve të rrezikuara, pasi ky riformulim do mbulonte me mire idene se nje zone e mbrojtur duhet te shpallet si e tille per te mbrojtur habitate dhe lloje me status te rrezikuar.

**Neni 12.** Kjo dispozitë bën fjalë dhe ka si synim të rregullojë procedurën e shpalljes së zonave të mbrojtura individuale, por shumësi i përdorur krijon konfuzion me sistemin kombëtar të zonave të mbrojtura dhe Planin Specifik të tërësisë së zonave të mbrojtura që është përcaktuar në nenin 5 të ligjit. Për këtë arsye, me qëllim evitimin e paqartësive dhe saktësimin se behet pjale për planifikimin në lidhje me shpalljen një zonë të mbrojtur të caktuar dhe jo me Planin Specifik të tërësisë së zonave të mbrojtura, sugjerojmë korigjimin gramatikor të shumësit me njëjës

**Nenet 13 dhe 47** duhet të rishikohen për të shmangur mungesën e konsistencës dhe për të ofruar më shumë qartësi lidhur me sistemin e nënzonimit. Është e rëndësishme të qartësohet se kush vendos kufijtë e nënzonimit të zonës së mbrojtur. Vendimi i Këshillit të Ministrave, Vendimi i KKT-së apo Plani i Menaxhimit?

**Neni 16 dhe 47** duhet të rishikohen për të shmangur paqartësitë lidhur me objektin e shpalljes së Kategorisë Park Kombëtar, aktivitetet e lejuara/ndaluara dhe aktivitetet e përcaktuara nga sistemi i nënzonimit në Nenin 47.

**Neni 19 dhe 47** duhet të rishikohen për të shmangur paqartësitë lidhur me objektin e shpalljes së Kategorisë Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror, aktivitetet e lejuara/ndaluara dhe aktivitetet e përcaktuara nga sistemi i nënzonimit në Nenin 47.

**Nenet 23 dhe 24** mund të rishikohen për të qartësuar diferencën midis kategorive Kurorë e gjelbër dhe Park Natyror.

**Neni 26** kërkon plotësim të dispozitave për përputhshmëri më të mirë me Konventën e Ramsarit në drejtim të përcaktimit më të mirë të kriterëve Ramsar si dhe plotësim të Nenit me kriteret për Zonat e Rëndësishme për Shpendët (IBAs).

**Neni 28** duhet të qartësojë diferencën midis Zonave të Vecanta të Ruajtjes/Konservimit (Special Areas of Conservation) dhe Zonave të Mbrojtjes së Vecantë/Special Protection Areas), të përafrojë dhe Direktivën e Shpendëve si dhe të vendosë kriteret për shpalljen e Zonave të Mbrojtjes së Vecantë (Special Protection Areas).

**Nenet 33 dhe 56** duhet të rishikohen për të shmangur mospërputhjet dhe për të siguruar më shumë qartësi për veprimtaritë e lejuara dhe veprimtaritë që kanë nevojë për leje.

**Nenet 35 dhe 36** kërkojnë rishikim për të mos toleruar heqjen e e statusit të zonës së mbrojtur apo pakësimin/reduktimin e ZM-së nëpërmjet shkatërrimit paraprak të saj. Po kështu neni kërkon ndryshim për të shmangur konfliktin e interesit në rolin e ministrise gjatë propozimit për heqje apo reduktim të zonës së mbrojtur.

**Neni 38** kërkon qartësim të detyrave të AKZM lidhur me aktivitetet monitoruese në Zonat e Mbrojtura si dhe qartësim të konceptit leje mjedis dhe deklaratë mjedisore.

**Neni 48** duhet të rishikohet, në mënyrë që të qartësojë nivelet A dhe B të Zonës Qendrore dhe veprimtarive përkatëse në nivelet e ndryshme të Nënzonës Qendrore. Ky nen ka nevojë të rishikohet së bashku me Nenin 16 në përputhje me udhëzuesit e IUCN për kategorinë përkatëse të menaxhimit dhe zonimin e brendshëm, si dhe për të shmangur mospërputhjet.

**Neni 49** duhet rishikuar në mënyrë që të detajohen më mirë veprimtaritë e ndaluara dhe ato të lejuara nga AKZM-ja, në përputhje me udhëzuesit e IUCN për kategorinë përkatëse të menaxhimit dhe zonimin e brendshëm.

**Pas Nenet 51** ka nevojë për dispozita shtesë lidhur me përcaktimet për zonën buferike dhe zonën e trashëgimisë dhe peisazhit kulturor në përputhje me udhëzuesit e IUCN për kategorinë përkatëse të menaxhimit dhe zonimin e brendshëm.

**Nenet 38 (5)/h, 57 dhe 58** të ligjit ekzistues për ZM-së, lejojnë vetëm regjim të centralizuar buxhetor, përcaktimin e centralizuar të tarifave dhe menaxhimit të ardhurave nga Ministria tek AKZM, ku AdZM-të nuk kanë pothuajse fare pavarësi buxhetore. Për ta trajtuar këtë çështje në përputhje me udhëzimet e IUCN-së, sa i takon mekanizmave të financimit, duhen lejuar autoritetet menaxhuese të ZM që të kenë buxhet dhe autonomi financiare, dhe të vendosin për lloje/nënkategori të ndryshme tarifash, përtej ose të ndryshme nga ato që përcaktohen me VKM për përcaktimin e tarifave, si dhe të menaxhojë në mënyrë autonome të ardhurat dhe financimet e saj.

**Neni 56**, mund të ndryshohet dhe të prezantohet mundësinë që Planet e Menaxhimit të përcaktojnë kriteret të standartizuara për aktivitetet e turizimit (*certifikimin Eco-Turizëm*), që mund të zhvillohen në një ZM ose në zonën buferike të saj, në mënyrë që lejimi i aktiviteteve turistike në një zonë të mbrojtur të jetë në përputhje jo vetëm me qëllimin e mbrojtjes së zonës, por edhe me parimet e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm, dhe evitimin e efekteve negative që mund të ketë turizmi masiv.

**Neni 73**, duhet rishikuar në mënyrë që të krijojë hapësira që në cdo rast kur shpallet një zonë e mbrojtur, apo kur një zonë ekzistuese rritet në status apo sipërfaqe, tu jepet mundësia dhe koha e arsyeshme aktiviteteve ekzistuese të pajisura me lejet përkatëse që të mbyllen gradualisht, të zhvendosen apo të transformohen kur dicka e tillë është e mundur.